



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.96/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVES - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) me seli ne Prishtine, te cilën me autorizim e përfaqëson E.XH. nga Prishtina, ndaj debitorit te përmbartimit NTSHP “Kalimashi” me seli ne fshatin Landovice, Komuna e Prizrenit, te cilën sipas autorizimit e përfaqëson M.Q. avokat ne Prizen, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm CP.nr.33/2021, të datës 06.07.2022, me datën 06.06.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) me seli ne Prishtine, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm CP.nr.33/2021, të datës 06.07.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar CP.nr.33/2021, të datës 06.07.2022, e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit NTSHP “Kalimashi” me seli ne fshatin Landovice, Komuna e Prizrenit, i paraqitur kundër aktvendimit për lejimin e përmbartimit E.nr.740/13 te datës 21.06.2013 të Gjykatës Themelore ne Prizren.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të konstatimit te gabuar te gjendjes faktike dhe aplikimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj këtë ankesë, aktvendimin e ankimuar ta anuloj dhe lëndën ta kthej ne rigjykim dhe rivendosje ne shkallë te parë.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

- **Ankesa e debitorit është e bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori më datën 24.05.2013, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit përmbartimorë aktvendimit te Komisionit te Pavarur per Miniera dhe Minerale (KPMM) KA.nr255, i datës 27.02.2007. Gjykata duke vendosur përkitazi me propozimin për përmbartim me aktvendimin E.nr.740/13 te datës 21.06.2013, ka lejuar

përmbartimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit, t'i paguaj shumën prej 69,904.00 euro, për shkak të ndëshkimit të shqiptuar.

Fillimisht, gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas propozimit, ka marrë aktvendim CP.nr.740/13 të datës 18.05.2018 me të cilin e ka hedhur poshtë propozimin, ndaj këtij aktvendimi pala kreditore ka ushtruar ankese, ku Gjykata e Apelit të Kosovës duke vendosur sipas ankesës me aktvendimin Ac.nr.4011/2018 të datës 15.10.2018 e ka anuluar aktvendimin e shkallës së parë dhe lenden e ka kthyer në rivendosje.

Në rivendosje, gjykata e shkallës së parë me aktvendimin CP.nr.740/13 të datës 10.06.2019, ka urdhëruar Drejtorin për Gjeodezi dhe Kadastër në Prizren, që të bëjë caktimin e shënimit të përmbartimit në librat publik dhe kredia në të holla të realizohet nga patundshmëritë e cekura si në aktvendimin e lartcekur.

Kundër aktvendimit përmbartimor CP.nr.740/13 të datës 10.06.2019 pala kreditore ka ushtruar ankese, e Gjykata e Apelit duke vendosur sipas ankesës me aktvendimin Av.nr.3461/2019 të datës 22.12.2020 ka anuluar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë CP.nr.740/13 të datës 10.06.2019.

Në rivendosje gjykata shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar duke ju përmbajtur sugjerimeve dhe vërejtjeve të gjykatës së shkallës së dytë, ka aprovuar si të bazuar propozimin dhe ka anuluar aktvendimin mbi lejimin e përmbartimit E.nr.740/13 të datës 21.06.2013 dhe të njëjtin e ka shfuqizuar në tërësi. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata ka konstatuar me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të dokumenti përmbartimor aktvendimit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) KA.nr.255, i datës 27.02.2007 pra në mbështetje të nenit 22 par.1.2, 24.3 të LPP-së. Mirëpo sipas Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (i cili ka qenë në fuqi në kohën e marrjes së vendimit nga organi i administratës) që një vendim të prodhojë efekt juridik, duhet të jetë i përpiluar në përputhje me këtë ligj, të ketë pjesën hyrëse, dispozitivin, arsyetimin, këshillën juridike, derisa në rastin konkret vendimi që ka shërbyer si dokument ekzekutiv nuk është përpiluar në përputhje me këtë ligj, e po ashtu ky vendim nuk përmban të dhëna mbi plotfuqishmërinë dhe ekzekutueshmërinë.

Bazuar në këto arsye, gjykata e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të bazuar në dispozita konkrete ligjore, ashtu që përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar nuk është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK dhe në konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Andaj, mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykate i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, pretendimet e kreditorit i refuzoi si të pabazuara sepse nuk ka ofruar prova juridikisht të vlefshme në mbështetje të tyre

Përndryshe, në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkalles së Dytë
K.DH.SH.II.nr.96/23, me datë 06.06.2023

Gjyqtari,
Faton Bajrami